

Statistikat e kulturës

Tremujori I 2017

Tiranë, më 11 Korrik 2017: Në tremujorin e parë 2017, janë realizuar 213 shfaqje kulturore, duke shënuar rënie me 25,5 %, kundrejt tremujorit të parë 2016. Numri i spektatorëve në tremujorin e parë të 2017 është rreth 43 mijë, duke pësuar rënie me 14,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Pjesëmarrja mesatare në tremujorin e parë 2017 është 203 spektatorë/vizitorë për shfaqje, dhe ka pësuar rritje me 15,1 %, krahasuar me tremujorin e parë 2016.

Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve/ekspozitave në institucionet kulturore

Numri i shfaqjeve/ekspozitave	Tr.1-2016	Tr.1-2017
Teatri Kombëtar Popullor	38	36
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor	40	12
Teatri Kombëtar Eksperimental	103	102
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	43	8
Galeria Kombëtare e Arteve	4	2
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	58	53
Shfaqje kulturore gjithsej	286	213

Teatri Kombëtar Eksperimental (TKE) është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve kulturore, 102 shfaqje/ekspozita në tremujorin e parë 2017. Në tremujorin e parë 2017, numri i spektatorëve është 13.647, duke shënuar rritje 9,8 %, krahasuar me tremujorin e parë 2016. Numri mesatar i spektatorëve në tremujorin e parë 2017 është 134 spektatorë/vizitorë për shfaqje me një rritje prej 10,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Numri i shfaqjeve kulturore të realizuara nga Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë në tremujorin e parë 2017 është 53 shfaqje/ekspozita, duke shënuar ulje me 8,6 %, krahasuar me tremujorin e parë 2016. Në tremujorin e parë 2017, numri i spektatorëve është 7.918 duke shënuar rritje me 38,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë 2016. Numri mesatar i spektatorëve në tremujorin e parë 2017 është 149 spektatorë/vizitorë për shfaqje duke pësuar rritje me 51,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve/vizitorëve në institucionet kulturore

Numri i spektatorëve /vizitorëve/audiencia	Tr.1-2016	Tr.1-2017
Teatri Kombëtar Popullor	13.902	12.310
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor	10.470	7.779
Teatri Kombëtar Eksperimental	12.427	13.647
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	2.800	360
Galeria Kombëtare e Arteve	5.020	1.141
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	5.726	7.918
Numri i spektatorëve gjithsej	50.345	43.155

Numri i frekuentuesëve të Bibilotekës Kombëtare në tremujorin e parë 2017 është 35.707, duke shënuar rënie me 31,3 %, krahasuar me tremujorin e parë 2016. Në tremujorin e parë 2017, në Bibliotekën Kombëtare janë afishuar 4.874 botime, 11,6 % më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga këto botime 927 ishin tituj të rinj dhe 3.947 ekzemplarë të rinj.

Tab. 3 Frekuentimi dhe botimet në Bibilotekën Kombëtare

Treguesit	Tr.1-2016	Tr.1-2017
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	41.493	38.343
Frekuentimi	51.972	35.707
Numri i botimeve	4.369	4.874
Numri i titujve të rinj gjatë vitit	869	927
Numri i ekzemplarëve të rinj gjatë vitit	3.500	3.947

Shënime Metodologjike

Në institucionet qendrore të artit përfshihen: Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP), Teatri Kombëtar (TK), Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" (TKEKS), Galeria Kombëtare e Arteve (GKA), Cirku Kombëtar (CK), Arkivi Qendror Shqiptar i Filmit (AQSHF), Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave (QKKFTK), Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA).

Të dhënat e statistikave të kulturës sigurohen nga Ministria e Kulturës.